



PROPOZIM

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d), nenit 40, paragrafi 40.2, pika c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-040, nenit 27 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2025, merr këtë:

V E N D I M P Ë R BARTJEN E MJETEVE NGA VITI 2024 NË VITIN 2025

- MIRATOHET** Vendimi për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake, nga viti 2024 në vitin 2025.
- Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, bëhet bartja e të hyrave vetjake nga vitit 2024 në vitin 2025, në vlerë prej **28,645,606.06**, respektivisht:

2.1. Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2024, në vlerë prej 28,645,606.06 €.

- Mjetet e bartura nga viti 2024 në vitin 2025 do të destinohen në kategoritë për:

*3.1. Mallra dhe shërbime – 130.....
2,739,305.06 €;*

*3.2. Investime kapitale – 300
25,906,301.00 €;*

Gjithsej: 28,645,606.06 €.

3.1. Mallra dhe shërbime – vlera totale sipas nënprogrameve 2,739,305.06 €.

3.1.1 Infrastruktura publike – Prishtinë – 18166 në vlerë prej 1,859,305.06 €,

3.1.2 Shërbimet e shëndetësisë primare – 73350 në vlerë prej 180,000.00 €,

3.1.3 Arsimi parashkollor – 92310 në vlerë prej 700,000.00 €.

3.2. Investimet kapitale – vlera totale sipas nënprogrameve 25,906,301.00 €.

3.2.1. Administrata - 16306 në vlerë prej 898,155.15 €;

3.2.2. Shërbimet publike – 18039 në vlerë prej 891,767.00 €;

3.2.3. Investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave – 18040 në vlerë prej 17,554,330.85 €;

3.2.4. Infrastruktura publike – 18166 në vlerë prej 520,000.00 €;

3.2.5. Menaxhimi i katastrofave natyrore – 18450 në vlerë prej 84,966.00 €;

3.2.6. Bujqësi – 47006 në vlerë prej 500,000.00 €;

3.2.7. Shërbimet e shëndetësisë primare – 73350 në vlerë prej 219,918.00 €;

3.2.8. Shërbimet sociale – 75526 në vlerë prej 580,000.00 €;

- 3.2.9. Shërbimet kulturore – 85006 në vlerë prej 2,009,328.00 €;
- 3.2.10. Sporti dhe rekreacioni – 85086 në vlerë prej 476,992.00 €;
- 3.2.11. Arsimi parashkollor – 92310 në vlerë prej 189,474.98 €;
- 3.2.12. Arsimi fillor, i mesëm i ulët – 93150 në vlerë prej 1,492,560.18 €;
- 3.2.13. Arsimi i mesëm i lartë – 94350 në vlerë prej 488,898.84 €.

- 4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa tabelare shtesë.
- 5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtoria e Financave.
- 6. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina

Arsyetim

Mbështetur në Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësi dhe Ligjin mbi Buxhetin, organizatat buxhetore realizojnë të drejtën për bartjen e mjeteve si bilance të kontraktuara në vijueshmëri për realizim të projekteve kapitale.

Dedikimi i këtyre mjeteve sipas kategorive do të jetë:

- Kategoria e mallrave dhe e shërbimeve, totali për bartje nga viti 2024 në vitin 2025 është në vlerë prej 2,739,305.06 €. Duke u bazuar në nenin 6, paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore, të hyrat vetanake komunale nga arsimi dhe nga bashkëpagesat e kujdesit primar shëndetësor, ku të hyrat e tilla autorizohen dhe shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime të arsimit, që është në vlerë prej 700,000.00 €, respektivisht vetëm për qëllimet e kujdesit primar shëndetësor, që është në vlerë prej 180,000.00 €, kategoria e mallrave dhe shërbimeve për arsim dhe shëndetësi është në vlerë prej 880,000.00 €, ndërsa shuma prej 1,859,305.06 € orientohet në programin e infrastrukturës publike – Prishtinë 18166 për shpenzime të ndryshme, për mbulimin e humbjeve në transportin privat të qytetarëve, si dhe në mirëmbajtjen dhe pastrimet e rrugëve dhe trotuareve, ndriçimeve, si dhe mbulimin e mjeteve të marra nga thesari për përmbarim nga Kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
- Kategoria e investimeve kapitale, janë obligime të mbetura ndaj kontratave të hapura, obligime të hapura ndaj projekteve aktive, obligime në vlerë prej 25,906,301.00 €.

Të bashkëngjitura janë në forma tabelare.

Komuna e Prishtinës - Bartja 2025

	Mallrat dhe shërbimet		Buxheti
1	18166 - INFRASTRUK.PUBLIKE-PRISHTINË		1,859,305.06
2	73350 - SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR PRISHTINË		180,000.00
3	92310 - ARSIMI PARAFILLOR & ÇERDHE-PRISHTINË		700,000.00
	TOTALI - MALLRA DHE SHËRBIME		2,739,305.06

	Projektet kapitale	Kodi pro.	Buxheti
	163060 - Administrata - Prishtinë		
1	FURNIZIMI ME PAJISJE TË IT-SË PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË PRISHTINËS	49653	150,000.00
2	NDËRTIMI I ANEKSIT DHE RENOVIMI I KOMUNËS SË PRISHTINËS	52542	500,898.95
3	NDËRTIMI I OBJEKTIT TË ARKIVIT TË KOMUNËS	52539	247,256.20
	TOTALI - KAPITALET		898,155.15

	18039 - Shërbimet publike		
1	NDËRTIMI I PARQEVË DHE HAPËSIRAVE TË REJA PUBLIKE REKREATIVE	52484	221,375.00
2	Ndërtimi i parkut në lagjen "Kalabria" faza III	54454	417,532.00
3	Ndërtimi i parkut te parku memorial në lagjen "Bregu i Diellit"	54462	100,000.00
4	Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbruese, hapja e puseve zona 1-Qendër- Sheshi "Nënë Tereza", Sheshi "Zahir Pajaziti", Bulevardi "Gjorgj	54465	127,312.00
5	Ndërtimi i parkut me hapësira gjelbruese në Zonat 1 & Zona 2, parku në rr. "Dëshmorët e Kombit", rr. "Tirana", rr. "Bill Clinton", rr. "UÇK", rr. "Agim	54466	25,548.00
	TOTALI - KAPITALET		891,767.00

	18040 - Investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave		
1	Rrethrotullimi Lakërishtë - Rrethrotullimi Arbëri	43194	465,828.90
2	VAZHDIMI I RRUGËS "B"	48038	531,648.80
3	RIKONSTRUIMI DHE NDËRTIMI I RRUGËS "ISA KASTRATI"	49746	339,567.69
4	Ndërtimi i sheshit "Gjorgj Bush" (nga hoteli Grand deri te Katedralja)	49930	500,000.00
5	RRUGA A - KOLEKTORI DHE RRUGA	51052	4,574,236.82
6	NDËRTIMI I RRUGËS NË LAGJEN "RRUSTEMI", "QAFA", "REXHË CUBI" DHE "SHIJAKU"	51700	449,502.68
7	NDËRTIMI I RRUGËS NË GRASHTICË	51708	128,769.52
8	NDËRTIMI I RRUGËS "SHKËNDIJA" NË ZLLATAR	52256	502,331.97
9	NDËRTIMI I URAVE NË PJESËN PERËNDIMORE TË UNAZËS QENDORE-LAK	52555	2,000,378.92
10	NDËRTIMI I RRUGËS "ABEDIN DINO" - KOLOVICË	52559	920,635.90
11	NDËRTIMI, RIKONSTRUIMI DHE SANIMI I DEFEKTEVE TË KANALIZIMEVE	52563	172,967.87
12	NDËRTIMI I MBIKALIMIT TE STACIONI I TRENIT-ARBËRI	52567	418,647.16
13	NDËRTIMI I RRUGËS BARILEVË - BARDHOSH-PRISHTINË	52569	190,715.95
14	NDËRTIMI I RR. "XHAVIT AHMETI"	52570	86,353.38
15	NDËRTIMI I STREHIMORES - PARKUT TË QENVE-SLIVOVË	52571	89,818.03
16	ASFALTIMI I RRUGËVE "QAMIL HOXHA", "2 KORRIKU" DHE "REXHEP LUCI"	52575	788,163.11
17	NDËRTIMI I NËNKALIMIT PËR VETURA NË RRUGËN "AGIM RAMADANI"	52580	200,000.00
18	NDËRTIMI I RRUGËVE -RR. "BASHKIM FEHMIU", "MINE PEZAI, "PAPA GJON PALI", "SHAHIN KOLONJA"	52653	200,378.57
19	ASFALTIMI I RRUGËVE-HAJVALI, SOFALI, KOLOVICË, VNESHITA	53526	375,302.47
20	NDËRTIMI I SHTATORES "ADEM JASHARI"	53604	50,000.00
21	NDËRTIMI I RRUGËVE NE ZONËN I: QENDRA - TOPHANE, DODONA, BREGU I DIELLIT, ULPIANA, DARDANIA, LAKËRISHTË	53930	411,095.04
22	NDËRTIMI I RR. "BAJRAM BAHTIRI"	53939	2,400,000.00
23	Ndërtimi i ishullit urban Arbëri - Pallati i Rinisë	54624	500,000.00
24	Rikonstruimi i platos në lagjen Dardania, rruga "Bill Clinton" (te Santea)	54625	107,988.07
25	Ndërtimi i tregjeve të gjelbra - (Ulpianë dhe tregun e gjelbër ekzistues prapa komunës)	54627	500,000.00
26	Ndërtimi i rrugëve në lagjen "Kodra e Trimave" - rr. "Xhevat Begolli", ndërtimi i rrugës "Balshaj", rikonstruimi i rrugës "Dalip Alshiqi"	54638	200,000.00
27	Ndërtimi i unazës së qytetit, segmenti-lindje-jug-perëndim (Prishtina e Re)	54648	450,000.00
	TOTALI - KAPITALET		17,554,330.85

	18166 - Infrastruktura publike - Prishtinë		
1	Ndërtimi i fontanave dhe rregullimi i pompave për furnizim me ujë - zona 1: qendra - Tophane, Dodona, Bregu i Diellit, Ulpiana, DardaNIA, Lakërishte dhe zona 2: Kodra e Trimave, Bërnice e Epërme	52526	75,000.00
2	Ndërtimi dhe rekonstrimi i pritoreve të autobusëve dhe bankave	53589	182,250.00
3	Ndërtimi i semaforëve dhe modernizimi i pajisjeve tjera për siguri në komunikacin - zona 1: qendra - Tophane, Dodona, Bregu i Diellit, Ulpiana, Dardania, Lakërishte, zona 2: Kodra e Trimave	53593	245,000.00
4	Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmorëve në fshatin Makoc	54578	17,750.00
	TOTALI - KAPITALET		520,000.00

	18450 - Menaxhimi i katastrofave natyrore		
1	Ndërtimi i shkallëve emergjente në shkollat "Asim Vokshi", "Emin Duraku", "Shkëndija", "Elena Gjika", "Faik Konica" dhe "Zenel Hajdini"	54398	84,966.00
	TOTALI - KAPITALET		84,966.00

	47006 - Bujqësi - Prishtinë		
1	NDËRTIMI I THERRTORES PUBLIKE DHE TREGU I KAFSHËVE NË PRISHTINË	49818	500,000.00
	TOTALI - KAPITALET		500,000.00

	73350 - Shërbimet e shëndetësisë primare		
1	NDËRTIMI I PUNKTIT TË RI PËR QMU DHE INVENTARIZIMI	52453	209,700.00
2	RENOVIME TË OBJEKTEVE TË QKMF DHE AMF-VE (QKMF 1,2,3,4,5,6,7)	53647	10,218.00
	TOTALI - KAPITALET		219,918.00

	75526 - Shërbimet sociale		
1	NDËRTIMI I QENDRËS MULTIFUNKSIONALE PËR PUNË SOCIALE	50824	580,000.00
	TOTALI KAPITALET		580,000.00

	85006- Shërbimet kulturore - Prishtinë		
1	RIKONSTRUIMI DHE RENOVIMI I OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE	49762	29,895.42
2	QENDRA KULTURORE DHE BIBLIOTEKA NË KODRËN E TRIMAVE (INVENTARI)	50864	418,000.00
3	RIKONSTRUIMI I PIKËS IKONIKE TË KRYEQYTETIT "KURRIZI"	52477	779,357.50
4	RENOVIMI I ARKIVIT TË QYTETIT, TEATRIT "DODONA", BIBLIOTEKËS "HIVZI SYLEJMANI"	53444	61,985.08
5	NDËRTIMI I SALLËS MULTIFUNKSIONALE TË KONCERTEVE TE TJEGULLORJA	53985	720,000.00
	TOTALI - KAPITALET		2,009,238.00

	85086 - Sporti dhe rekreacioni - Prishtinë		
1	RENOVIMI DHE RREGULLIOMI I HAPËSIRAVE KOMUNALE PËR NEVOJAT E KOMUNITETIT	40440	145,565.00
2	NDËRTIMI I TRIBUNËS LINDORE NË STADIUMIN "2 KORRIKU"	50815	18,694.00
3	NDËRTIMI I TOALETEVE DHE DHOMAVE TË ZHVESHJES NË FUSHAT E FUTBOLLIT TË: "FC PRISHTINA" DHE KF "KOSOVA E PRISHTINËS" BËRNICË	52531	120,000.00
4	NDËRTIMI I TRIBUNËS "FLAMURTARI"	53986	142,733.00
5	Ndërtimi, renovimi i hapësirave sportive në lagjet: Dardania, qendra Bregu i Diellit, Mat, Gërmi, Koliq, Besi, Arbëri, Emshiri, Lagjja e Universitetit	54451	50,000.00
	TOTALI - KAPITALET		476,992.00

	92310 - Arsimi parashkollor		
1	RENOVIMI I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT NË ÇERDHET "YLLKAT" DHE "DIELLI", SHKOLLA "EMIN DURAKU"	53174	89,282.11
2	NDËRTIMI I ÇERDHES "XIXËLLONJAT"	53351	36,996.00
3	NDËRTIMI I ANEKSIT TË ÇERDHES "ARDHMËRIA"	53661	63,196.87
	TOTALI - KAPITALET		189,474.98

	93150 - Arsimi fillor, i mesëm i ulët		
1	NDËRTIMI I ANEKSIT TË SHKOLLËS "PAVARËSIA"	50971	125,627.09
2	NDËRTIMI I SHKOLLËS NË LAGJEN "KALABRIA"	52657	198,726.70
3	RENOVATION OF PRIMARY SCHOOLS: "ASIM VOKSHI", "ZENEL HAJDINI"	53600	924,698.39
4	BLERJA E PAJISJEVE PËR BIBLIOTEKAT SHKOLLORE NË "ISMAIL QEMAJLI", "GJERGJ FISHTA", "METO BAJRAKTARI", "ASIM VOKSHI", "MODEL"	53602	81,200.00
5	PAJISJE, REKUIZITA SPORTIVE DHE PAJISJE TJERA "ISMAIL QEMAJLI", "GJERGJ FISHTA", "FAIK KONICA", "DARDANIA", "ALI KELMENDI"	53607	22,679.80
6	INSTALIMI I ELEKTRIKËS, GJENERATORËVE, KLIMA "METO BAJRAKTARI"	53611	10,000.00
7	Ndërtimi i terreneve sportive dhe rregullimi i oborreve "Sami Frashëri, "Ismail Qemajli", "Hasan Prishtina", "Asim Vokshi", "Zenel Hajdini", etj.	54616	129,628.20
	TOTALI - KAPITALET		1,492,560.18

	94350 - Arsimi i mesëm i lartë		
1	NDËRTIMI I SHKOLLËS SË MESME "7 SHTATORI"	49679	349,148.84
2	PAJISJE (IT, SHKENCË) PËR KABINETE NË "HOXHE KADRI PRISHTINA"	53605	60,000.00
3	Ndërtimi, renovimi i shkoll. "Sami Frashëri", "Ismail Qemajli", "Hasan Prishtina", "Asim Vokshi", "Zenel Hajdini", "Xhevdet Doda", "Nazim Gafurri"	54613	79,750.00
	TOTALI KAPITALET		488,898.84

	Totali i kapitaleve nga bartja		25,906,301.00
--	---------------------------------------	--	----------------------

	KATEGORITË EKONOMIKE		Buxheti
1	TOTALI MALLRA DHE SHËRBIME	13	2,739,305.06
2	TOTALI KAPITALE	30	25,906,301.00
	TOTALI I BARTJES SË MJETEVE		28,645,606.06

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina
.....



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, nenit 40, paragrafi 40.2, pika **b** të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28 qershor 2008), nenit 61, paragrafi 61.2 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika **b** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2025, merr këtë

**V E N D I M
PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE PËR PERIUDHËN
2026-2028**

- I.** Miratohet Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2026-2028.
- II.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2026-2028.
- III.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtoria e Financave.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT
.2025**

**KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina**



Republika e Kosovës
Republic Kosovo – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtine
Opština Pristina – Municipality of Prishtine



Drejtoria e Financave

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

2026-2028

Korniza afatmesme buxhetore komunale	3
Objektivat e Kornizës afatmesme buxhetore komunale	4
Objektivat e Komunës së Prishtinës	4
Objektivat e Qeverisë së Kosovës	4
Objektivat dhe përfitimet e procesit të KAB-së për komunat	5
Objektivat	6
Struktura organizative e Komunës së Prishtinës	7
Programet.....	8
Pjesëmarrja e programeve buxhetore në grantin qeveritar 2026-2028	11
Perspektiva e politikave fiskale	11
Pjesëmarrja e granteve në buxhet, sipas viteve, 2026 – 2028	11
Parashikimi i të hyrave vetanake komunale.....	12
Plani i të hyrave vetanake komunale 2026 – 2028	14
Vlerësimet e hershme të shpenzimeve të programeve buxhetore.....	16
Grantet qeveritare dhe të hyrat vetjake 2026 – 2028.....	16
Buxheti 2026-2028 dhe deklaratat e misioneve dhe vizioneve sipas programeve buxhetore - drejtorive.....	17

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2026 - 2028

Korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Prishtinës, është dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, që do të pasqyrojë caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike, për të përmbushur objektivat e përcaktuara me Strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Si pjesëpërbërëse e Kornizës afatmesme buxhetore (KAB), është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2026/2028, të dhëna nga Ministria e Financave (MF), përmes Qarkores buxhetore 2026/01 për komunat, si dhe financimi nga grantet qeveritare dhe kufijtë fillestarë të buxhetit komunal për vitin 2026 dhe parashikimet për periudhën 2027 - 2028, që janë miratuar nga Komisioni i granteve, si pjesë integrale e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) 2026/2028, e miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 15 maj 2025.

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit, që bën ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare. Me Kornizën afatmesme buxhetore – komunale, do t'i paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Prishtinës, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën, me të cilën buxheti i Komunës do t'i përmbushë dhe përkrahë projektet me prioritet, që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2026/2028, gjithnjë duke u bazuar në:

- Ligjin për financat e pushtetit lokal;
- Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Ligjin për vetëqeverisjen lokale;
- Ligjin për kufijtë administrativë komunalë.

OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2026-2028, planifikohet në bazë të buxhetit, i cili bazohet në Buxhetin e programeve, në objektivat dhe në deklaratat e misioneve të programeve. KAB-ja komunale 2026-2028, është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores buxhetore nr. 2026/01, e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve. Në KAB-në komunale paraqiten edhe deklaratat dhe misionet e drejtorive lidhur me punën e tyre pasuese trevjeçare.

❖ Objektivat e Komunës së Prishtinës:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit;
- Menaxhimi i arkëtimit të mbeturinave, duke ndihmuar ndërmarrjen publike për pastrim;
- Hartimi i planit zhvillimor komunal dhe planeve rregulluese në zonat urbane;
- Zhvillimi i fushës së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
- Përfshirja e tërësishme në arsim parashkollor, fillor dhe të mesëm, si dhe ngritja e nivelit të arsimit;
- Zhvillimi i fushës së kulturës, rinisë dhe sportit;
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme;
- Përkrahja e të rinjve dhe ulja e papunësisë;
- Zhvillimi i turizmit kulturor, historik dhe malor;
- Subvencionimet në bujqësi;
- Përkrahja e OJQ-ve në përgjithësi, e në veçanti organizatat e të rinjve.

❖ Objektivat e Qeverisë së Kosovës:

- Rritja dhe qëndrueshmëria ekonomike;
- Punësimi dhe mirëqenia;
- Sundimi i ligjit dhe shteti ligjor;
- Integrimet evropiane, politika e jashtme dhe çështjet e sigurisë;
- Arsimi, shkenca, kultura, rinia dhe sporti;
- Shëndetësia moderne.

❖ Objektivat dhe përfitimet e procesit të KAB-së për komunat

Përfshirja e qasjes së KAB-së në proceset e buxhetit komunal, është i motivuar nga qëllimet e mëposhtme:

- Të ofrojë kornizë gjithëpërfshirëse dhe reale për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore për tri vitet e ardhshme;
- Të rrisë parashikimin dhe qëndrueshmërinë e planifikimit të buxhetit, përmes futjes së parashikimit më të besueshëm të të hyrave komunale dhe shpenzimeve në perspektivë trevjeçare;
- Të përmirësojë lidhjen në mes procesit të alokimit të burimeve dhe prioriteteve të politikave komunale;
- Të fuqizohen drejtoritë komunale në shpërndarjen e burimeve, menaxhim dhe shfrytëzim;
- Të bëhet planifikimi sa më objektiv nëpër kategori ekonomike – BDMS;
- Të bëhet alokimi i mjeteve buxhetore për vitet e ardhshme sipas kategorive ekonomike;
- Planifikimi i investimeve kapitale përmes sistemit të PIP-së;
- Përfshirja e buxhetit gjinor në të gjitha fushat, si një implementim i nevojshëm për të garantuar parimin e barazisë gjinore.

Objektivat:

a) Shtimi i efikasitetit dhe efektivitetit:

Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal;

- Planifikimi i buxhetit në kode dhe nënkode ekonomike;
 - Shfrytëzimi maksimal i burimeve;
 - Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve;
 - Kryerja e punëve në mënyrë të duhur dhe cilësore;
- Përzgjedhja e punëve me prioritet për realizim.

b) Rritja e të hyrave vetjake:

- Rritja e efikasitetit në arkëtim;
- Mundësia për zbatimin e tarifave të reja.

c) Kontrolli dhe reduktimi i shpenzimeve

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme;
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë;
- Përparësia nga blerja me shumicë;
- Përmirësimi i performancës për mallra dhe shërbime;
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat kornizë.

d) Ngritja e kapaciteteve njerëzore

Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore;

Përdorim i software-ve të avancuar për shërbime;

Profesionalizimi i shërbimeve.

e) Sigurimi i disiplinës financiare:

- Harmonizim me politikat financiare, ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative;
- Ekzistenca e kontrolleve interne – auditori i brendshëm dhe zbatimi i rekomandimeve;
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik;
- Analiza të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve;

- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parësë së gatshme (Kesh plani);
- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas programit të BDMS – SZHMB;
- Planifikimi dhe realizimi investimeve kapitale sipas programit të PIP-së (Programi i investimeve publike);
- Respektimi i Ligjit të buxhetit - mos hyrja në obligime pa mbulesë - zotim të mjeteve.

f) Ekonomia:

- Zhvillimi i Strategjisë komunale për promovim ekonomik;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për donatorë të brendshëm dhe të jashtëm;
- Strategjia për zhvillimin rural;
- Strategjia për biodiversitet;
- Menaxhimi i mbeturinave.

Struktura organizative e Komunës së Prishtinës

616	KOMUNA E PRISHTINES	
1.1	160	Zyra e Kryetarit
1.1.1	16006	Zyra e Kryetarit
1.2	169	Zyra e Kuvendit të Komunës
1.2.1	16906	Zyra e Kuvendit të Komunës
1.3	163	Administrata dhe Personeli
1.3.1	16306	Administrata
1.4	166	Inspektimet
1.4.1	16611	Inspektimet
1.5	167	Prokurimi
1.5.1	16730	Prokurimi
1.6	175	Buxheti dhe financat
1.6.1	17506	Buxheti
1.6.2	17581	Tatimi ne Prona
1.7	180	Shërbimet publike, Mbrojtja civile, Emergjencia
1.7.1	18040	Investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave
1.7.2	18166	Infrastruktura publike
1.7.3	18230	Zjarrfikësit dhe inspektimet
1.7.4	18039	Menaxhimi i parqeve dhe hapësirave publike
1.7.5	18450	Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencave

1.8	195	Zyra komunale për komunitete dhe kthim
1.9	470	Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural
1.9.1	47006	Bujqësia
1.10	480	Zhvillimi ekonomik
1.10.1	48006	Planifikimi i zhvillimit ekonomik
1.11	650	Kadastri dhe gjeodezia
1.11.1	65030	Shërbimet kadastrale
1.12	660	Planifikimi urban dhe mjedisi
1.12.1	66335	Planifikimi urban dhe inspeksioni
1.13	730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale
1.13.1	73015	Administrata
1.13.2	73350	Shërbimet e shëndetësisë primare
1.14	755	Shërbimet sociale
1.14.1	75526	Shërbimet sociale
1.14.2	75527	Shërbimet rezidenciale
1.15	850	Kultura, rinia dhe sportet
1.15.1	85006	Shërbimet kulturore
1.15.2	85086	Sporti dhe rekreacioni
1.16	920	Arsimi dhe shkenca
1.16.1	92030	Administrata
1.16.2	92310	Arsimi parashkollor dhe çerdhet
1.16.3	93150	Arsimi fillor
1.16.4	94350	Arsimi i mesëm

Programet:

a. Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparenca:

- Respektimi i procedurave të prokurimit;
- Evidenca e duhur financiare dhe procedurat e kontabilitetit;
- Inventarizimi i duhur dhe menaxhimi i pronës;
- Koordinimet në mes drejtorive – programeve buxhetore;

- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat;
- Menaxhimi i bazës së të dhënave;
- Informimi publik.

b. Përmirësimi i bazës së të hyrave vetjake komunale:

- Rritja e performancës së arkëtimit të tarifave dhe taksave komunale;
- Regjistrimi i tatimpaguesve të rinj për tatimin në pronë;
- Tarifa (ngarkesa) të reja për shërbime të reja;
- Tarifa (taksa) ekonomikisht të arsyetuara;
- Ngarkesa të reduktuara (periodike).

Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat:


- Kontrolli për parandalimin e ndërtimit ilegal të shtëpive dhe objekteve të tjera;
- Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje;
- Zbatimi dhe respektimi i rregulloreve komunale;
- Shqyrtimi i Planit të punës 2026;
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës për vitin 2026;
- Përgatitja e Kornizës afatmesme buxhetore 2026-2028;
- Përgatitja e qarkoreve interne komunale;
- Mbajtja e dëgjimeve buxhetore me qytetarë;
- Përgatitja e planeve rregulluese dhe detaje;
- Përmirësimi i mbledhjes bazike të të dhënave dhe analiza e tyre;
- Shqyrtimi i përgjegjësisë dhe i obligimeve komunale;
- Menaxhimi i projekteve;
- Menaxhimi i bazës së të dhënave;
- Monitorimi;
- Vlerësimi;

1.1. Korniza makroekonomike

Korniza makroekonomike është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas kriterëve të Kornizës afatmesme buxhetore (KAB).

Pjesëmarrja e programeve buxhetore në totalin e grantit qeveritar 2026.

Komuna	Granti i përgjithshëm	Granti specifik për Arsim	Granti specifik për Shëndetësi	Ligji për Kryeqytet	Të hyrat vetjake	Gjithsej financimi 2026
Prishtinë	46,029,108	30,932,322	12,115,627	20,311,620	41,244,772	150,633,449



2. Pjesëmarrja e granteve në totalin e buxhetit, sipas viteve 2026 – 2028

2.1. Perspektiva e politikave fiskale

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale, politikës së të ardhurave, si nga granti i Qeverisë, të hyrave vetjake komunale dhe shpenzimeve. Me Kornizën afatmesme buxhetore 2026 – 2028, e cila është miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 15.05.2025, bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe Kornizës makrofiskale 2026-2028, Qeveria është përkushtuar që duke e ruajtur stabilitetin fiskal, të përkrahë edhe kërkesat e organizatave buxhetore, duke paraparë ndërmarrjen e një varg masash, që nga kursimet në kategorinë e shpenzimeve operative – si rezultat i rekomandimeve të FMN-së , e deri te marrja e masave konkrete në realizimin e të hyrave në nivel qendror dhe lokal, si:

- Kontroll më efikas dhe mbledhje e detyrueshme për ngarkesat dhe tarifat e mbledhura në nivel lokal;
- Sensibilizim i qytetarëve për të kryer obligimet ndaj Komunës;
- Zyrat komunale të tatimit në pronë, udhëzohen të bëjnë rekomandimet e tyre në vendosjen e zonave të vlerësimit të normave tatimore, nivelin e përpjekjeve në mbledhjen e tatimit në pronë, me qëllim të arritjes së të hyrave të planifikuara të tatimit në pronë të paraparë me projektbuxhet.

Parashikimi i të hyrave vetjake të Komunës së Prishtinës për periudhën 2026-2028

Të hyrat komunale të Komunës së Prishtinës realizohen në bazë të Ligjit mbi financat e pushtetit lokal, Rregullores mbi tarifat dhe ngarkesat komunale, Rregullores mbi tatimin në pronë, si dhe dispozitave tjera ligjore, të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale, me të cilat Komuna ka të drejtë të caktojë dhe arkëtojë të hyra të tjera komunale.


Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë tatimi në pronë dhe të hyrat nga lejet e ndërtimit, të cilat të hyra duhet shpenzuar, dhe ekskluzivisht dedikohen në fushën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime të tjera, gjë që ju kthehen qytetarëve (tatimpaguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës publike komunale.

Të hyrat e Komunës për periudhën 2026-2028, parashihet të arkëtohen nga:

- Tatimi në pronë
 - Tatimi në tokë,
 - Taksa për mbeturina,
- Taksat për leje ndërtimi,
- Taksat administrative komunale,
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë afariste,
- Taksat për lejen për shërbime profesionale,
- Taksat për automjete motorike,
- Taksat nga kadastri dhe gjeodezia,
- Taksat për certifikata,
 - Participim në Arsim,
 - Participim në Shëndetësi,
 - Të hyra të tjera.

KOMUNA	Taksat, ngarkesat dhe të hyrat tjera jo tatimore	Të hyrat nga tatimi në pronë	Projeksionet për vitin 2026
PRISHTINË	26,020,980	15,123,792	41,144,772

TE HYRAT VETJAKE TE KOMUNES SE PRISHTINËS PËR VITIN 2026



■ Taksat, ngarkesat dhe të hyrat tjera jo tatimore

■ Të hyrat nga tatimi në pronë

Taksa komunale për leje ndërtimi, është gjithashtu një kategori e rëndësishme e të hyrave. Gjatë planifikimit të kësaj të hyre, Komuna ende nuk është e sigurt me gjendjen e legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje. Të gjitha objektet që nuk janë të legalizuara, por janë pjesë e planit urban, do të legalizohen, po ashtu me miratimin e Ligjit mbi tatimin në tokë, gjatë vitit 2026, të rritet arkëtimi i THV-së.

Me qëllim të rritjes së të hyrave vetjake, Komuna do të formojë një ekip për ngritjen e performancës së të hyrave vetjake për vitet e ardhshme.

Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale 2026 – 2028

Nr.	PËRSHKRIMI	2026	2027	2028
1	Taksa për leje ndërtimi	11,532,137	12,204,999	12,247,880
2	Legalizimi i ndërtimeve pa leje	450,000	500,000	500,000
3	Leje mjedisore komunale	800,843	834,029	834,029
4	Tatimi në pronën e paluajtshme dhe tokë	15,123,792	16,641,506	16,641,506
5	Menaxhimi i mbeturinave	4,338,000	4,338,000	4,338,000
6	Licenca në biznes	350,000	400,000	400,000
7	Taksa për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike	250,000	300,000	300,000
8	Konfiskimi i veturave - me merimangë	100,000	100,000	100,000
9	Infrastrukturë rrugore	3,500,000	4,000,000	4,000,000
10	Taksa nga kadastra dhe gjeodezia	1,200,000	1,200,000	1,200,000
11	Të hyra nga inspekcioni	150,000	150,000	150,000
12	Taksa për certifikata dhe doku. zyrtare	250,000	250,000	250,000
13	Taksa për automjete motorike	850,000	900,000	900,000
14	Taksa për shërbime arsimore	800,000	800,000	800,000
15	Biblioteka dhe teatri "Dodona"	20,000	20,000	20,000
16	Taksa për shërbime shëndetësore	400,000	400,000	400,000
17	Të hyrat tjera të papërcaktuara	15,000	15,000	15,000
18	Shitja e pasurisë	15,000	15,000	15,000
19	Shpronësime	1,000,000	1,000,000	1,000,000
	Gjithsej	41,144,772	44,068,534	44,111,415

Parashikimi i të hyrave buxhetore 2026 - 2028

Të hyrat vetjake **41,244,772.00 euro** të planifikuara për vitin 2026, do të arkëtohen kryesisht nga taksa për leje ndërtimi, taksa për infrastrukturë rrugore, tatimi në pronën e paluajtshme, tatimi në tokë, nga legalizimi i ndërtimeve pa leje dhe nga menaxhimi i mbeturinave. Burime sekondare të të hyrave do të jenë edhe të hyrat nga shpronësimet e tokave komunale dhe taksa për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike. Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve dhe agjencive qeveritare ndërkombëtare, përfshirë bashkëfinancimin e mundshëm, janë përfshirë në kuadër të të hyrave nga participimet dhe donacionet.

Vlerësimet e hershme të shpenzimeve të programeve buxhetore

Në vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore, përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor, duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal, dhe duke pasur për bazë buxhetin e miratuar për vitin 2026 dhe shpenzimet gjatë viteve të fundit. Kjo kornizë paraqet parashikimin trevjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale.

Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të rritjes për çdo vit, si dhe të granteve të Qeverisë, të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve buxhetore dhe limiteve të buxhetit, të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i granteve të MF-së.

Grantet qeveritare dhe të hyrat vetjake komunale 2026 - 2028

Në vazhdim janë paraqitur granti i përgjithshëm, granti specifik për kryeqytetin, granti specifik i Arsimit, granti specifik për Shëndetësi, dhe plani i të hyrave vetanake komunale sipas viteve 2026 – 2028 .

Tabela 1: Vlerësimet e burimeve të financimit për Komunën e Prishtinës (2025-2028)

Burimet e financimit	Buxheti aktual	Buxheti i planifikuar	Parashikimet e hershme ¹	
	2025	2026	2027	2028
Grandi i përgjithshëm	31,427,358	46,029,108	46,449,254	50,249,223
Grandi specifik për Arsim	27,093,624	30,932,322	31,860,292	32,816,101
Grandi specifik për Shëndetësi	11,738,786	12,115,627	12,479,096	12,853,469
Grandi specifik për Kryeqytetin	18,449,340	20,311,620	21,870,360	23,618,820
Të hyrat vetjake	38,391,116	41,144,772	44,068,534	44,111,415
Financim nga huamarrja	1,000,000	2,000,000	-	-
Gjithsej	128,100,224	150,633,499	157,727,536	164,649,028

Tabela 2: Planifikimi i shpenzimeve për Komunën e Prishtinës (2025-2028)

Kategoritë e shpenzimeve	Buxheti aktual	Buxheti i planifikuar	Parashikimet e hershme	
	2025	2026	2027	2028
Paga dhe mëditje	42,740,109	47,000,000	50,000,000	53,000,000
Mallra dhe shërbime	29,000,000	39,000,000	40,000,000	42,000,000
Shpenzime komunale	3,000,000	3,500,000	4,000,000	4,500,000
Subvencione dhe transfere	5,000,000	7,000,000	7,500,000	8,000,000
Investime kapitale	48,360,114	54,133,449	56,227,536	57,149,028
Gjithsej	128,100,224	150,633,499	157,727,536	164,649,028

Propozimet e projekteve për Investimeve kapitale për vitet 2026- 2028, janë si në vijim:

	Drejtoria e Parqeve	2026	2027	2028
1	Parqet dhe hapësirat e reja publike/rekreative ne zonat urbane dhe rurale ne Komunën e Prishtinës. Lidhja e zonave te gjelberta përmes krijimit te korridoreve ne Komunës se Prishtinës.	1,100,000.00	1,300,000.00	1,500,000.00
2	Shtrirja e sistemit te ujitjes ne parqet dhe hapësirat e Komunës se Prishtinës	350,000.00	380,000.00	400,000.00
3	Furnizimi me fidanë dhe shkurre shumëvjeçare për hapësirat e qytetit dhe parqet (pyllëzimi urban)	300,000.00	400,000.00	450,000.00
4	Ndërtimi dhe mirëmbajtja e këndeve publike te lodrave	300,000.00	450,000.00	450,000.00
5	Ndertimi i parkut “Bardha”	800,000.00	1,000,000.00	500,000.00
5	Parku Botanik	1,500,000.00	500,000.00	500,000.00
	Totali - Drejtoria e Parqeve	4,350,000.00	4,030,000.00	3,800,000.00
	Drejtoria e Mirëqenies Sociale	2026	2027	2028
1	Inventarizimi i Qendrës për Punë Sociale aktuale	100,000.00	150,000.00	170,000.00
	Totali - Drejtoria e Mirëqenies Sociale	100,000.00	150,000.00	170,000.00
	Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencës	2026	2027	2028
1	Vendosja e kamerave të sigurisë në Kryeqytet	400,000.00	-	-
	Totali - Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencës	400,000.00	-	-
	Drejtoria e Shëndetësisë	2026	2027	2028
1	Furnizim me inventar për nevojat e objekteve te shëndetësisë primare	300,000.00	300,000.00	350,000.00
2	Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e shëndetësisë primare	180,000.00	220,000.00	300,000.00
3	Furnizimi me auto vetura për nevojat e shëndetësisë primare	50,000.00	150,000.00	200,000.00
4	Furnizim me pajisje të teknologjisë informative (PC, Llap top, Projektor, Printer etj.) për nevojat KPSH-së	200,000.00	250,000.00	200,000.00
	Totali - Drejtoria e Shëndetësisë	730,000.00	920,000.00	1,050,000.00

	Drejtoria e Arsimit	2026	2027	2028
1	Ndërtimi i anekseve/hapësirave në IEA për mësimin tërëditor	250,000.00	250,000.00	300,000.00
2	Furnizim me pajisje dhe mjete për Kabinete	200,000.00	210,000.00	200,000.00
3	Furnizim me libra për bibliotekat shkollore në IEAA	50,000.00	40,000.00	450,000.00
4	Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative për IEAA	250,000.00	300,000.00	350,000.00
5	Pajisja e shkollave me rekuizita sportive dhe pajisje tjera sportive	150,000.00	150,000.00	170,000.00
6	Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikes, gjeneratorëve dhe klimave	70,000.00	110,000.00	115,000.00
7	Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në IEAA ne	80,000.00	60,000.00	100,000.00
	Totali - Drejtoria e Arsimit	1,050,000.00	1,120,000.00	1,685,000.00
	Drejtoria e shërbimeve publike	2026	2027	2028
1	Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik	1,500,000.00	1,700,000.00	2,000,000.00
2	Ndriçim sinjalizues për vendkalime për siguri, ndërtimi dhe modernizimi i semaforëve, shtyllat antiparking dhe pistonat lëvizëse	400,000.00	450,000.00	500,000.00
3	Ndërtimi dhe funksionalizimi i kontejnerëve nëntokësor dhe gjysmë-nëntokësor	500,000.00	1,100,000.00	1,350,000.00
4	Rregullimi dhe ndërtimi i ashensorëve ne zonat urbane te Kryeqytetit	150,000.00	200,000.00	200,000.00
5	Ndërtimi dhe Rikonstruimi i fontanave te qytetit	100,000.00	150,000.00	200,000.00
6	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	200,000.00	200,000.00	500,000.00
7	Ndërtimi i rrethojave për siguri në mobilitet	350,000.00	380,000.00	400,000.00
8	Mobilieria Urbane (shporta, ulëse, drita dekorative)	150,000.00	250,000.00	300,000.00
	Totali - Drejtoria e shërbimeve publike	3,350,000.00	4,430,000.00	5,450,000.00
	Drejtoria e Infrastrukturës	2026	2027	2028
1	Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëse në zonën urbane dhe rurale të kryeqytetit	300,000.00	300,000.00	300,000.00
2	Bashkeinvestim me KFW PER NDERTIMIN E rrjetin e kanalizimit fekal (ne qytet)	3,000,000.00	3,000,000.00	3,000,000.00
3	Ndërtimi i rrugës "B", faza III (pjesa e lartme e rrugës)	1,200,000.00	-	-
4	Ndërtimi i kolektorëve në Fshatin Hajvali.	500,000.00	-	-

5	Rruga lidhëse Kolovice-Sofali (Rruga Abedin Dino)	2,100,000.00	200,000.00	-
6	Ndërtimi i Rrugëve ne lagjen Arbëria e Re	500,000.00	500,000.00	500,000.00
7	Ndërtimi i Rrugëve ne lagjen e Muhaxhirëve	500,000.00	500,000.00	500,000.00
8	Ndërtimi i Rrugëve ne lagjen Hajvalia	500,000.00	500,000.00	500,000.00
9	Ndërtimi i Rrugëve ne lagjen Kalabria	500,000.00	500,000.00	500,000.00
10	Ndërtimi i Rrugëve ne lagjen Kodra e Trimave	500,000.00	500,000.00	500,000.00
11	Ndërtimi i Rrugëve ne lagjen Kolovica	500,000.00	500,000.00	500,000.00
12	Ndërtimi i Rrugëve ne lagjen Mat (Matiqan)	500,000.00	500,000.00	500,000.00
13	Ndërtimi i krahëve te Rr. Muharrem Fejza sipas planit rregullues	500,000.00	1,000,000.00	-
14	Realizimi i projektit rruga "A".	3,000,000.00	5,000,000.00	10,000,000.00
15	Ndërtimi i kanalizimit fekale në fshatra	600,000.00	500,000.00	500,000.00
16	Ndërtimi i rrugëve ne Bardhosh-Bernice	300,000.00	500,000.00	-
17	Ndërtimi i rrugëve në Barilevë, Prugovc, Lebanë, Rimanishtë, dhe Besi	500,000.00	500,000.00	-
18	Ndërtimi i Unazës se Kryeqytetit	1,000,000.00	500,000.00	1,000,000.00
19	Ndërtimi i Unazës Qendër të Qytetit, ne drejtim te Mitrovicës	1,000,000.00	-	-
20	Ndërtimi i kolektorit atmosferik nga fusha e Pajtimit, në drejtim të fshatrave Makovc, Llukar dhe Grashticë.	500,000.00	1,000,000.00	-
21	Ndërtimi i Rr. Ilaz Agushi, nga gjimnazi "Sami Frashëri" në drejtim të tregut të gjelbër.	100,000.00	500,000.00	-
22	Ndërtimi i rrugës mbi kolektorin e "Lumit Prishtina" në pjesën e poshtme të lagjes "Kalabria".	500,000.00	1,000,000.00	1,000,000.00
23	Investime në rrjetin e ujësjellësit brenda zonës urbane dhe në një pjesë të madhe të fshatrave të Gollakut (duke përfshire edhe projektin/studimin)	800,000.00	500,000.00	500,000.00
24	Ndërtimi i shtresës finale të rrugës Stallov - Zllashë	200,000.00	-	-
25	Ndërtimi i Rr. Holger Petersen - faza II	500,000.00	1,000,000.00	
26	Intervenime emergjente ne 6 zona te qytetit dhe fshatrave	3,000,000.00	3,500,000.00	4,000,000.00
27	Investime ne infrastrukturën rrugore ne fshatrat Mramor, Koliq, Ballaban, Sharban,	500,000.00	700,000.00	-

28	Lidhja e sheshit “Nënë Tereza” me zonën e qytetit të vjetër të Prishtinës	200,000.00	200,000.00	200,000.00
29	Sheshi Xhorxh Bush	5,500,000.00	7,000,000.00	-
30	Sheshi Rexhep Luci	100,000.00	-	-
31	Ndërtimi i rrugës me katër kori ‘Bajram Bahtiri’ në Llukar.	2,400,000.00	-	-
	Totali - Drejtoria e Infrastrukturës	31,800,000.00	30,400,000.00	24,000,000.00
	Drejtoria e Transformimit	2026	2027	2028
1	Ndërtimi i objektit të ri për Qendrës për Punë Sociale	2,000,000.00	500,000.00	-
2	Ndërtimi i shtëpisë për mbrojtje të fëmijëve(të cenueshëm)	150,000.00	60,000.00	-
3	Renovime te qendrave te ndryshme sociale (Qëndrimet ditore për te moshuar, QPS, etj.).	100,000.00	100,000.00	-
4	Shtëpia për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare	500,000.00	1,000,000.00	300,000.00
5	Ndërtimi i terreneve dhe hapësirave sportive ne Komunën e Prishtinës dhe renovimi I atyre ekzistuese	250,000.00	250,000.00	200,000.00
6	Ndërtimi i tribunës KF “Ramiz Sadiku”	200,000.00	100,000.00	-
7	Finalizimi i tribunës KF “2 Korriku”	200,000.00	100,000.00	-
8	Ndërtimi i tribunës për Klubin KF "Rilindja"	200,000.00	250,000.00	-
9	Ndërtimi i sallës Multifunkionale	2,000,000.00	2,000,000.00	3,000,000.00
10	Ndërtimi i shtigjeve për vrapim	100,000.00	100,000.00	50,000.00
11	Ndërtimi i tualeteve dhe dhomave te zhveshjes ne fushat e futbollit te FC “Prishtina” dhe KF “Kosova e Prishtinës” ne Bërnice	100,000.00	100,000.00	100,000.00
12	Intervenimet infrastrukturore dhe funksionalizimi i fushave sportive ne Bardhosh, Barilev, Matiqan dhe Bërnice	100,000.00	150,000.00	100,000.00
13	Ndërtimi i fitneseve natyrale në parqe dhe kënde strategjike të Prishtinës, me pajisje që i rezistojnë natyrës.	100,000.00	100,000.00	100,000.00
14	Ndërtimi dhe riparimi i fushave te sportit ne Kodrën e Trimave	100,000.00	150,000.00	150,000.00
15	Ndërtimi i fushave te tenisit dhe Padelit	100,000.00	200,000.00	200,000.00
16	Ndërtimi I Tribunës Flamurtari	250,000.00	-	-
17	Renovimi i Tereneve multifunkionale te fushave ne Gërmi,	250,000.00	100,000.00	70,000.00

18	Ndërtimi i parkut te biçikletave	200,000.00	120,000.00	80,000.00
19	Renovimi i infrastrukturës së objekteve te shëndetësisë primare	400,000.00	500,000.00	500,000.00
20	Ndërtimi i Spitalit te Prishtinës	5,000,000.00	10,000,000.00	10,000,000.00
21	Renovimi dhe rigjenerimi i pikës ikonike të Kryeqytetit "Kurrizi"	500,000.00	-	-
22	Ndërtimi i Bibliotekës të Qendrës Kulturore	400,000.00	400,000.00	-
23	Ndërtimi i ATC	500,000.00	500,000.00	500,000.00
24	Ndërtimi i sallës Koncertale	4,000,000.00	2,500,000.00	2,500,000.00
25	Revidimi i projektit, konservimi dhe adaptimi i shtëpisë shkollë në muzeun e shtëpive shkolla, lagja e Herticëve	700,000.00	600,000.00	200,000.00
26	Dizajnimi dhe ndërtimi i Muzeut të Paqes	400,000.00	500,000.00	600,000.00
27	Dizajnimi dhe Rikonstruimi i Objektit të Kino Rinisë	500,000.00	2,000,000.00	2,000,000.00
28	Restaurimi i shkollës së parë shqipe	200,000.00	250,000.00	1,000,000.00
29	Revitalizimi i objektit tek stacioni i trenit.	500,000.00	800,000.00	500,000.00
30	Ndërtimi i shkollës ne Lagjen Kalabria	2,100,000.00	200,000.00	-
31	Ndërtimi i shkollës ne Lagjen Mati 1	2,000,000.00	1,000,000.00	2,000,000.00
32	Ndërtimi i shkollës “7 Shtatori”	850,000.00	-	-
33	Ndërtimi i çerdhes/kopshtit ne Lagjen Kolovice	1,000,000.00	100,000.00	-
34	Ndërtimi i çerdhes/kopshtit ne Lagjen Mati 1	1,500,000.00	100,000.00	-
35	Ndërtim i çerdhes "Lulevera"	900,000.00	200,000.00	500,000.00
36	Renovime dhe mirëmbajtja e shkollave	1,500,000.00	1,300,000.00	2,000,000.00
37	Rregullimi i oborreve dhe terreneve sportive	200,000.00	200,000.00	500,000.00
38	Furnizimi me inventar për shkolla	250,000.00	300,000.00	350,000.00
39	Ndërtimi i Thertores publike dhe Tregut të kafshëve në Bernicë të Epërme	1,500,000.00	1,000,000.00	1,800,000.00
40	Efiçienca e energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë (kredi e EBRD)	1,000,000.00	1,000,000.00	1,000,000.00
41	Rigjenerimi i piketave (landmark) urbane te Kryeqytetit	300,000.00	500,000.00	500,000.00

42	Ndërtimi i pritoreve të autobusëve të transportit publik	500,000.00	500,000.00	500,000.00
43	Ndërtimi i qendrës së grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave ndërtimore	200,000.00	200,000.00	200,000.00
44	Ndërtimi i nënkalimit për vetura ne rrugën Agim Ramadani	3,000,000.00	2,000,000.00	3,700,000.00
45	Platforma ndërlidhëse e Arbërisë me Pallatine e Rinise	2,500,000.00	1,500,000.00	1,000,000.00
46	Ndërlidhja e zonës 'Qendra' me lagjet përreth, përmes platformave të gjelbërta dhe shtigjeve të transportit alternativ.	400,000.00	500,000.00	500,000.00
47	Ndërtimi i mbikalimit tek stacioni i trenit, i cili lidhet me Pallatin e Rinisë.	500,000.00	1,200,000.00	-
48	Ndërtimi i mbikalimit tek shkallët e "Arbërisë".	150,000.00	500,000.00	-
49	Ndërtimi i nënkalimit që lidh "Rrethin e Flamurit" me rrethin e QKUK-së i cili do të ketë të integruar edhe një parking nëntokësor të hyrja e qytetit në zonën në mes tre rathëve.	500,000.00	2,500,000.00	3,200,000.00
50	Nënkalim për vetura në pjesën nga Katedralja në drejtim të Fakultetit Filologjik.	-	2,000,000.00	-
51	Lidhja e sheshit "Nënë Tereza" me zonën e qytetit të vjetër të Prishtinës	1,600,000.00	500,000.00	-
52	Krijimi i sheshit "Historik të Prishtinës" dhe lidhja e saj deri të zona e rrethit të flamurit.	-	2,500,000.00	2,500,000.00
53	Mbi nënkalim nga Veterniku deri të stacioni i autobusëve, ndërtohet hapësira urbane që ndërlidh dy lagjet e mëdha të qytetit, "Dardaninë" dhe "Kalabrinë".	2,500,000.00	3,000,000.00	-
54	Ndërtimi i objektit te zjarrfikëseve	200,000.00	400,000.00	700,000.00
57	Ndërtimi i shtatores se Adem Jasharit	500,000.00	-	-
58	Ndërtimi I objektit te NPL Gjelbert	250,000.00	500,000.00	-
59	Ndërtimi i parkut perkujtimore Dr. Ibrahim Rugova dhe Biblioteka Presidenciale	400,000.00	3,500,000.00	3,500,000.00
60	Liceu Artistik	2,500,000.00	2,500,000.00	3,000,000.00
61	Fillimi I implementimit të Master Planit për Gollakun	300,000.00	500,000.00	1,000,000.00
62	Ndërtimi i projekteve te regjenerimit Kodra e trimave,Kolovica dhe prishtina e Vjeter	5,000,000.00	10,000,000.00	10,000,000.00
63	Ndërtimi i tregjeve	1,000,000.00	2,500,000.00	2,500,000.00
	Totali - Drejtoria e Transformimit	55,100,000.00	66,130,000.00	63,100,000.00

Sqarim :

Këto projekte të propozuara mund të ndryshojnë me raportin e përpunimit të buxhetit 2026, pas pranimi të Qarkores së dytë nga MF (2026/02), ku përcaktohen kufijtë buxhetor dhe dëgjimeve publike me qytetarët e Kryeqytetit.